

VENDIM
Nr.830, datë 30.11.2011

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, të bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 04550 “Transporti hekurudhor”, “Shpenzime kapitale”, të zbritet fondi prej 12 350 000 (dymbëdhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 06180 “Strehimi dhe urbanistika”, “Shpenzime kapitale”, të shtohet fondi prj 12 350 000 (dymbëdhjetë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për pagesat e kontributeve të bashkisë Himarë dhe komunës Lukovë, në kuadër të projektit “Menaxhimi i integruar dhe pastrimi i zonës bregdetare” (ICZMP).

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha